

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6814
E mërkurë, 1 shkurt 2023
çmimi 0.40 €

Përkujtohen heronjtë Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADA SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË PRISHTINË KA MBAJTUR TAKIM ME ZYRTARË TË QEVERISË SË KOSOVËS, LIDERË TË PARTIVE POLITIKE, PJESËTARË TË SHOQËRISË CIVILE DHE DIPLOMATË PËR ASOCIACIONIN E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË

HOVENIERU: NUK MBËSHTETIM MARRËVESHJE QË KËRCËNON SOVRANITETIN E KOSOVËS | FAQE 4-5



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë të martën se vendi i tij nuk e mbështet asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën e Kosovës ose

që kërcënon sovranitetin, pavarësinë dhe karakterin shumetnik të saj. "Ne kundërshtojmë rreptësisht krijimin e një entiteti që i ngjan Republikës Sërpska në Bosnjë-

Hercegovinë", ka deklaruar Hovenier pas diskutimit që ka organizuar Ambasada Amerikane në Prishtinë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë

AKTUALE



JAPONIA DHE NATO-ja BASHKOHEN KUNDËR KËRCËNIMEVE TË KINËS DHE RUSISË | F. 2

PËR 22 MUJ NË FSK JANË REALIZUAR SHTATË PROCESA TË GRADIMIT DHE EMËRIMIT TË USHTARAKËVE | F. 3

NË KOSOVË STREHOHEN KATËR GAZETARË AFGANË | F. 6

EKONOMI



MIRATOHET RAPORTI I KOMISIONEVE PËR BYRONË SHTETËRORE PËR VERIFIKIMIN E PASURISË | F. 8

BANKAT E EUROZONËS SHTRËNGOJNË DHËNIEN E KREDIVE | F. 8

SPORT



MORINA EMËROHET PËRZGJEDHËS I PËRFAQËSUES U17 | F. 10

KDI-ja: KOSOVA VAZHDON PËRMIRËSIMIN NË INDEKSIN E PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT | FAQE 3



VON CRAMON IA DORËZON PARLAMENTIT EVROPIAN DRAFTRAPORTIN PËR KOSOVËN | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Japonia dhe NATO-ja bashkohen kundër kërcënimeve të Kinës dhe Rusisë

TOKIO, 31 JANAR - Japonia dhe NATO duhet të "vazhdojnë të jenë të bashkuara dhe të vendosura" në dritë të kërcënimeve të sigurisë që paraqesin Kina, Koreja e Veriut dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, tha në Tokio shefi i aleancës ushtarake perëndimore, Jens Stoltenberg.

Stoltenbergu paralajmëroi se Pekini po vëzhgon nga afër zhvillimet në Ukrainë dhe "po mëson gjëra që mund të ndikojnë në vendimet e ardhshme". Këto komente ai i bëri pasi zhvilloi një takim me kryeministrin e Japonisë, Fumio Kishida.

Shefi i NATO-s vizitoi Japoninë në kuadër të turneut të tij në Azi, që synon t'i forcojë lidhjet me aleatët demokratikë. "Çfarë po ndodh në Evropë sot mund të ndodhë në Azinë Lindore nesër. Prandaj, ne duhet të qëndrojmë të bashkuar dhe të vendosur, të qëndrojmë së bashku për liri dhe demokraci", tha ai.

Stoltenbergu dhe Kishida thanë se janë të shqetësuar nga rritja e bashkëpunimit që kanë parë midis Kinës dhe Rusisë. "Ne theksuam me shqetësim rritjen e bashkëpunimit ushtarak të Rusisë me Kinën, përfshirë edhe

përmes operacioneve dhe stërvitjeve në afërsi të Japonisë", thanë dy zyrtarët përmes një deklarate të përbashkët.

Një ditë më parë Stoltenbergu i kërkoi Koresë së Jugut që ta rrisë mbështetjen ushtarake për Ukrainën e cila po përballlet me pushtimin rus që pothuajse një vit.

Por, të martën ai vlerësoi lart "qëndrimin e fortë" dhe "mbështetjen substanciale" që Japonia i ka dhënë Ukrainës.

Tokio ka vendosur sanksione ndaj Moskës së bashku me partnerët e tjerë të G7-s dhe, po ashtu, ka ndërmarrë hapa të rrallë duke dërguar pajisje të mbrojtjes dhe ka ofruar strehim për personat që ikin nga konflikti.

Stoltenbergu tha se ai dhe Kishida, po ashtu, kanë ndarë shqetësimin lidhur me "sjelljen provokuese" të Koresë së Veriut nisur nga aktiviteti bërthamor deri te testimi i raketave balistike. Ai tha se Kina "nuk është armikja jonë", por paralajmëroi për rritjen e pranisë së saj ushtarake në Azi, "përfshirë edhe të armëve bërthamore, ngacmimit të fqinjëve dhe kërcënimit ndaj Tajvanit", po ashtu edhe



përhapjen e dezinformave lidhur me NATO-n dhe Ukrainën.

Kishida tha se Japonia do të themelojë një zyrë të një përfaqësuesi të pavarur që do të merret me NATO-n si pjesë e përpjekjeve për ta thelluar bashkëpunimin me aleancën

ushtarake.

Japonia, po ashtu, do ta shqyrtojë mundësinë që të marrë pjesë vazhdimisht në takime të nivelit të lartë të aleancës, shtoi Kishida.

Në dhjetorin e vitit të kaluar Japonia njoftoi për ndryshimin më të madh të strategjisë së saj të

mbrojtjes dhe sigurisë.

Strategjia e re përfshin plane për t'i rritur shpenzimet për mbrojtje në 2 për qind të Bruto Prodhimit Vendor deri në vitin fiskal 2027, duke bërë që Japonia të jetë në përputhje me udhëzimet e NATO-s sa i përket shpenzimeve për mbrojtjen.

Bideni thotë se ShBA-ja nuk do të dërgojë avionë luftarakë në Ukrainë

WASHINGTON, 31 JANAR - Presidenti amerikan Joe Biden tha se Shtetet e Bashkuara nuk do të dërgojnë avionë luftarakë F-16 në Ukrainë edhe pse presidenti francez, Emmanuel Macron tha se Franca nuk e përjashton dërgimin e tyre nëse plotësohen disa kushte.

Bideni u përgjigj "jo" në pyetjen e gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë nëse ai ishte në favor të dërgimit të tyre.

Macron u pyet më 30 janar në një konferencë të përbashkët shtypi në Hagë me kryeministrin holandez, Mark Rutte, nëse Franca po shqyrtonte dërgimin e avionëve luftarakë. "Asgjë nuk është e përjashtuar, por disa kushte duhet të plotësohen së pari", tha ai, pa dhënë më shumë detaje. Ukraina duhet t'i kërkojë zyrtarisht avionët, tha Macroni, i cili pritet të takohet me ministrin ukrainas të Mbrojtjes, Oleksiy Reznikov, në Paris, më 31 janar.

Rutte tha se Ukraina nuk kishte kërkuar zyrtarisht avionë luftarakë F-16 nga Holanda dhe aktualisht "nuk flitet për dërgimin e F-16 në Ukrainë. Nuk ka asnjë kërkesë".

Ministri i Jashtëm holandez, Wopke Hoekstra, u tha ligjvënësve në fillim të këtij muaji se nuk kishte "asnjë tabu" për dërgimin e avionëve luftarakë.

Ndërkohë në Berlin, ambasadori ukrainas në Gjermani tha se Kiev nuk i kishte kërkuar ende Gjermanisë t'i furnizonte me avionë luftarakë, por vuri në dukje se sa të rëndësishëm do të ishin ata.

Avionët luftarakë janë pjesë e përpjekjeve të Ukrainës për ta mbrojtur hapësirën e saj ajrore dhe për t'u mbrojtur kundër raketave të lëshuara në qytetet dhe infrastrukturën e Ukrainës, tha Oleksiy Makeyev për transmetuesin "Deutsche Welle". Komentet e tij erdhën pasi kancelari gjerman Olaf Scholz përsëriti më 29 janar se Gjermania nuk do të dërgojë avionë luftarakë në Ukrainë.

Scholz u pajtua javën e kaluar për të dërguar 14 tanke Leopard 2 në Ukrainë dhe për t'i lejuar vendet e tjera evropiane të dërgonin të tyre, pas disa javësh debat intensiv dhe presion në rritje nga aleatët.

Pas këtij vendimi, zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, tha



se vendimet e Perëndimit, përfshirë edhe dërgimin e tankeve, po krijojnë një situatë "shumë, shumë të tensionuar" të sigurisë në Evropë dhe për botën në përgjithësi.

Ukraina ka muaj që kërkon tanke luftarake për t'i luftuar forcat ruse që e kanë nisur luftën në këtë shtet.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky beson se rreth 300

tanke do të ndihmonin në mposhtjen e Rusisë. Polonia, Spanja, Finlanda, Holanda dhe Norvegjia dhe disa shtete të tjera pritet të dërgojnë tanket e tyre Leopard në Ukrainë.

KDI-ja: Kosova vazhdon përmirësimin në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 JANAR - Transparency International ka publikuar të martën Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2022. Ky indeks publikohet në baza vjetore, për 180 shtete të botës, duke përdorur një metodologji vlerësuese e cila është e bazuar në burime kredibile të institucioneve ndërkombëtareve. Vlerësimi fillon nga zero deri në 100 pikë - ku zero është niveli më i lartë i korrupsionit dhe 100 pikë do të thotë shoqëri pa korrupsion.

Rezultatet e CPI për vitin 2022 tregojnë që shumica e shteteve kanë pasur pak apo fare progres në luftimin e korrupsionit, duke bërë që më shumë se 2/3 e shteteve të botës të kenë probleme serioze me korrupsionin dhe të jenë nën vlerën mesatare prej 50 pikëve.

Për vitin 2022 Kosova është vlerësuar me 41 pikë, duke u ranguar në vendin e 84-të në ranglistën botërore prej 180 shtetesh. Ky rezultat reflekton një trend të vazhdueshëm dhe inkurajues të përmirësimit të Kosovës krahasuar me vitet e kaluara. Krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova renditet në vendin e dytë, pas Malit të Zi (45), ndërsa lë pas Maqedoninë e Veriut (40), Shqipërinë dhe Serbinë (36), si dhe Bosnjë-Hercegovinën (34). Sidoqoftë, Kosova mbetet larg mesatares botërore prej 50-pikësh, ndërsa shumë larg mesatares së BE-së prej 66-pikësh.

Progresi i atribuohet përmirësimit të kornizës ligjore për financimin e partive politike si dhe pakos së ligjeve për reformimin e sistemit të drejtësisë. Sidoqoftë, përfshirja e aktorëve relevantë në kuadër të këtyre reformave vlerësohet si e mangët, shpesh e përcjellë me bojkote. Puna e institucioneve, me theks të ekzekutivit, shpesh është përcjellë me rënie të nivelit të transparencës. “Mungesa e skandaleve, sidomos atyre të mëdha të korrupsionit, është ndërlidhur me nivelin shumë të

ulët të shpenzimeve dhe investimeve kapitale - që si faktor ka reduktuar potencialin për raste të korrupsionit. Sidoqoftë, kjo nuk duhet parë asses si strategji që duhet ndjekur në luftimin e korrupsionit nga ana e ekzekutivit. Në raport me sektorin e drejtësisë, kanë qenë evidente rastet kur ekzekutivi ka ndërhyrë në punën dhe pavarësinë e gjyqësorit, sidomos me vendimin për uljen e pagave dhe deklarimeve publike mbi disa raste gjyqësore. Po ashtu, shkurtimi i buxhetit për institucionet e përfshira në parandalimin e korrupsionit, si

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, bie ndesh me prioritetet e ekzekutivit në luftën kundër korrupsionit”, ka njoftuar KDI.

KDI-ja ka theksuar se përkundër inicimit të rasteve “Brezovica” dhe “Subvencionet” nga institucionet e drejtësisë, mosefikasiteti i gjyqësorit vazhdon të manifestohet me politikë të ulët ndëshkimore dhe prolongim të trajtimit të rasteve të mëdha të korrupsionit, duke përfshirë rastet e njohura si “Hydrocentralet”, “Toka”, “Veteranët”, “Stenta” apo “53 milionëshi”. “Për më tepër, edhe gjatë vitit të kaluar ka

vazhduar fenomeni i politizimit të bordeve përmes praktikave të emërimit të anëtarëve nga radhët e partisë në pushtet. Në disa prej ndërmarrjeve kryesore publike në vend, në të cilat ka pasur ndryshim menaxhmenti, të emëruarit janë persona të afërt, ish-zyrtarë politikë apo persona të lidhur me partinë në pushtet. Me qëllim të luftimit sa më efektiv të korrupsionit, veçanërisht të nivelit të lartë, qeveria duhet të garantojë një reformë në drejtësi në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me koordinim sa më të mirë me të gjithë aktorët relevantë. Në këtë

drejtim, qeveria duhet të përmbahet nga çfarëdo ndërhyrje në sistemin e drejtësisë për të garantuar kontroll dhe balancë mes pushteteve. Qeveria nuk duhet të hezitohet në shpenzimin e parasë publike nga frika e rasteve të korrupsionit. Përkundrazi, në këtë periudhë me nivele rekorde të inflacionit, do të duhej që të ketë sa më shumë investime publike dhe kapitale për t'i përmbushur prioritetet dhe nevojat e qytetarëve, gjithnjë duke u siguruar që prokurimet publike zhvillohen në transparencë dhe llogaridhënie të plotë”, ka njoftuar KDI-ja.



CORRUPTION PERCEPTIONS INDEX 2022

The perceived levels of public sector corruption in 180 countries/territories around the world.

SCORE	COUNTRY/TERRITORY	SCORE	COUNTRY/TERRITORY	SCORE	COUNTRY/TERRITORY	SCORE	COUNTRY/TERRITORY	SCORE	COUNTRY/TERRITORY
90	Denmark	87	Chile	82	Grenada	42	Solomon Islands	36	Sri Lanka
87	Finland	87	United Arab Emirates	81	Malta	42	Timor Leste	36	Thailand
87	New Zealand	85	Barbados	81	Rwanda	42	Trinidad and Tobago	36	Turkey
84	Norway	84	Bahamas	81	Saudi Arabia	42	Vietnam	34	Bosnia and Herzegovina
83	Singapore	83	Israel	80	Croatia	41	Kosovo	34	Gambia
83	Sweden	82	Korea, South	80	Mauritius	40	Guyana	34	Indonesia
82	Switzerland	82	Lithuania	49	Namibia	40	India	34	Malawi
80	Netherlands	82	Portugal	48	Vanuatu	40	Maldives	34	Nepal
79	Germany	80	Botswana	47	Jordan	40	North Macedonia	34	Paraguay
79	Ireland	80	Cabo Verde	47	Malaysia	40	Suriname	34	Russia
79	Luxembourg	80	Saint Vincent and the Grenadines	46	Armenia	40	Tunisia	33	Kyrgyzstan
79	Hong Kong	80	Spain	45	Romania	40	El Salvador	33	Pakistan
79	Australia	80	Latvia	45	China	39	Mongolia	33	Algeria
79	Canada	80	Qatar	45	Cuba	39	Philippines	33	Cameroon
79	Estonia	80	Czechia	45	Montenegro	39	Ukraine	33	Madagascar
79	Iceland	80	Georgia	45	Sao Tome and Principe	39	Brazil	33	Mozambique
79	Uruguay	80	Italy	44	Bahrain	38	Ethiopia	33	Uganda
79	Belgium	80	Slovenia	44	Jamaica	38	Morocco	33	Bangladesh
79	Japan	80	Dominica	43	Oman	38	Lesotho	33	Guinea
79	United Kingdom	80	Poland	43	Benin	37	Cote d'Ivoire	33	Iran
79	France	80	Saint Lucia	43	Bulgaria	37	Tanzania	32	Afghanistan
79	Austria	80	Costa Rica	43	Ghana	37	Albania	32	Cambodia
79	Seychelles	80	Sri Lanka	43	Senegal	36	Ecuador	32	Niger
69	United States of America	82	Slovakia	43	South Africa	36	Kazakhstan	31	Bolivia
68	Bhutan	82	Cyprus	42	Burkina Faso	36	Panama	31	Laos
68	Taiwan	82	Greece	42	Hungary	36	Peru	31	Mexico
								31	Uzbekistan
								30	Djibouti
								30	Egypt
								30	Eswatini
								30	Mauritania
								30	Papua New Guinea
								30	Togo
								29	Gabon
								28	Mali
								28	Paraguay
								28	Russia
								27	Kyrgyzstan
								27	Pakistan
								26	Cameroon
								26	Algeria
								26	Madagascar
								26	Mozambique
								26	Uganda
								25	Bangladesh
								25	Guinea
								25	Iran
								24	Afghanistan
								24	Cambodia
								24	Niger
								24	Central African Republic
								24	Lebanon
								24	Guatemala
								24	Guatemala
								24	Nigeria
								24	Tajikistan
								23	Azerbaijan
								23	Honduras
								23	Iraq
								23	Myanmar
								23	Zimbabwe
								22	Eritrea
								22	Sudan
								21	Congo
								21	Guinea Bissau
								20	Democratic Republic of the Congo
								19	Chad
								19	Comoros
								19	Nicaragua
								19	Turkmenistan
								17	Burundi
								17	Equatorial Guinea
								17	Haiti
								17	Libya
								17	Korea, North
								16	Yemen
								14	Venezuela
								13	South Sudan
								13	Syria
								12	Somalia



This work from Transparency International (2022) is licensed under CC BY-ND 4.0

#cpi2022

www.transparency.org/cpi

This work from Transparency International (2022) is licensed under CC BY-ND 4.0

Për 22 muaj në FSK janë realizuar shtatë procese të gradimit dhe emërimit të ushtarakëve

PRISHTINË, 31 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka bërë me dije se për 22 muaj në FSK janë realizuar shtatë procese të gradimit dhe emërimit të ushtarakëve. “Edhe një sukses i madh i radhës! Përgjatë 22 muajve janë realizuar 7 procese të gradimit dhe emërimit të ushtarakëve tanë me numrin prej rreth 1 000 gradimeve dhe mbi 3 000 emërimeve të reja”, ka thënë

Mehaj. Ai ka theksuar se ndër objektivat e tij operacionale, përveç të tjerash, është avancimi i sistemit të qëndrueshëm të menaxhimit të karrierës sipas kriterëve dhe standardeve më moderne të menaxhimit të karrierës së ushtarakëve tanë në të gjitha rangjet, profilet dhe nivelet. “Proceset e avancimit dhe emërimit mbi bazën e njohurive, shkathtësive, aftësive

dhe përvojës së ushtarakëve janë thelbësore për ruajtjen dhe forcimin e moralit ushtarak dhe gatishmërisë efektive operacionale të forcave. Jemi në rrugë të mbarë ta avancojmë edhe më tej sistemin aktual sikur secilin projekt tjetër deri më tani. Së bashku do të arrijmë të bëjmë më të mirën me rregulloren e re të zhvillimit të karrierës”, ka deklaruar ministri Mehaj.





AMBASADA SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS NË PRISHTINË KA MBAJTUR TAKIM ME ZYRTARË TË QEVERISË SË KOSOVËS, LIDERË TË PARTIVE POLITIKE, PJESËTARË TË SHOQËRISË CIVILE DHE DIPLOMATË PËR ASOCIACIONIN E KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE NË KOSOVË

Hovenieri: Nuk mbështetim marrëveshje që kërcënon sovranitetin e Kosovës

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë të martën se vendi i tij nuk e mbështet asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën e Kosovës ose që kërcënon sovranitetin, pavarësinë dhe karakterin shumetnik të saj. “Ne kundërshtojmë rreptësisht krijimin e një entiteti që i ngjan Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë”, ka deklaruar Hovenieri pas diskutimit që organizoi Ambasada Amerikane në Prishtinë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 31 janar - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Jeff Hovenier, ka thënë se vendi i tij e ka bërë të qartë tashmë se “nuk mbështet asnjë marrëveshje që shkel Kushtetutën e Kosovës” ose që “kërcënon sovranitetin, pavarësinë dhe karakterin shumetnik” të saj. “Ne kundërshtojmë rreptësisht krijimin e një entiteti që i ngjan Republikës Sërpska në Bosnjë-Hercegovinë”, ka deklaruar Hovenier.

Ai i ka bërë këto komente pas një diskutimi që ka organizuar të martën Ambasada Amerikane në Prishtinë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Marrëveshja për formimin e këtij Asociacioni është arritur në vitin 2013 në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, por ajo nuk është zbatuar kurrë.

Në Prishtinë, zyrtarët thonë se nuk mund ta lejojnë formimin e një asociacioni njëetnik me kompetenca ekzekutive, ndërsa në Beograd insistojnë në themelimin

e tij.

Hovenier tha se ShBA-ja pret që “Kosova t’i përmbushë obligimet e saj”. “Ne kërkojmë nga Qeveria e Kosovës ta ofrojë vizionin e saj për Asociacionin, që beson se mbron të ardhmen e Kosovës si shtet sovran, i pavarur, shumetnik, demokratik, dhe siguron të drejtat e pakicave në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe Kushtetutën e Kosovës. Ne jemi të gatshëm të ofrojmë ekspertizë dhe mbështetje politike, për t’u siguruar se ai funksionon në interes të të gjithë kosovarëve”, ka deklaruar Hovenier.

Ambasadori amerikan theksoi se partneriteti i ShBA-së me Kosovën “është i palëkundur”. “Diskutimi i sotëm reflektoi miqësinë tonë të thellë dhe të gjatë me popullin e Kosovës. Ne donim t’i kuptonim këndvështrimet e pjesëmarrësve për Asociacionin, çfarë mund të jetë, si mund të realizohet për qytetarët e Kosovës, por edhe çfarë kapacitesh nuk mund apo nuk duhet të ketë”, ka thënë ai.

Në diskutimin e organizuar nga Ambasada Amerikane morën pjesë zyrtarë të Qeverisë së

Kosovës, liderë të partive politike, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe diplomatë.

Ministri për Komunitete dhe Kthim në Qeverinë e Kosovës, Nenad Rashiq, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se pjesëmarrësit diskutuan për kornizën politike dhe ligjore të Asociacionit dhe se “diskutimi ishte interesant”. “Ka pasur replika dhe mendime të ndryshme por, në përgjithësi, mendoj se cilësia e bisedimeve ka qenë në nivel të lartë”, ka thënë Rashiq pa dhënë detaje.

Rashiq, i cili në disa raste ka përsëritur se marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi nuk mund të injorohen, shtoi se të pranishmit në këtë takim ishin “bashkëbisedues relevantë”. “Ka potencial për bisedime të mëtejshme”, ka thënë ai.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka bërë me dije se të martën i është përgjigjur pozitivisht ftesës së ambasadorit të ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, për takim të përbashkët me përfaqësues të qeverisë, partive politike dhe

shoqërisë civile, ku është diskutuar për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Me këtë rast, PDK-ja nëpërmjet një deklarate publike ka vlerësuar lart angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në të gjitha fazat më të rëndësishme të vendit, nga çlirimi, pavarësia dhe shtetndërtimi. “Qëndrimet e Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me dialogun janë të qarta, publike dhe konsistente. Rrjedhimisht, PDK-ja në vazhdimësi i ka dhënë mbështetjen e nevojshme dhe e ka inkurajuar qeverinë për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse me Serbinë, ligjërisht dhe ndërkombëtarisht të obligueshme, me njohjen reciproke të qendër. Partia Demokratike e Kosovës do ta japë gjithmonë kontributin e saj aktiv, kur në pyetje është interesi i shtetit dhe i qytetarëve të Kosovës”, është thënë në deklaratën e PDK-së.

Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, e kundërshton Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, duke thënë se nuk mund të lejojë krijimin e një strukture njëetnike me

Kundërshtohet formimi i Asociacionit në protestën e thirrur nga Sadri Ramabaja

Prishtinë, 31 janar - Një numër i qytetarëve kanë protestuar të martën në sheshet e Prishtinës kundër formimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kjo protestë është thirrur nga Sadri Ramabaja nga Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë, i afërt me partinë në pushtet, Lëvizjen Vetëvendosje.

Qytetarët e mbledhur në këtë protestë kanë kërkuar nga ndërkombëtarët t'i rishikojnë qëndrimet e tyre karshi kësaj kërkesë ndaj Kosovës.

Në pankartat që mbanin në duar përcillnin mesazhin kundër themelimit të asociacionit. "Kjo protestë duhet parë thjesht si fillim i shpërthimit të uraganit

popull. Ai nuk lejon nëpërkëmbjen e Republikës", ka shkruar në "Facebook" Sadri Ramabaja.

Një nga përfaqësuesit e protestuesve ka thënë se shqiptarët janë kundër asociacionit. "Askush në Kosovë nuk e harron ndihmën e Evropës gjatë luftës për liri dhe për ndërtimin e Kosovës së pavarur.

Evropa duhet ta dijë se shqiptarët masivisht janë kundër asociacionit sepse janë të bindur që ky copëzim i ri do ta çojë shtetin në të njëjtën gjendje ku e ka çuar Bosnjën, Republika Serbe e Bosnjës", u shpreh ai, duke shtuar se protestat do të jenë masive gjithandej. "Protestat do të jenë masive gjithandej, paqësore

dhe në mbështetje të qeverisë Kurti që po punon me të gjitha forcat për ta ruajtur integritetin dhe sovranitetin e Kosovës. Shqiptarët do të luftojnë për ta ndaluar asociacionin e institucionet evropiane duhet ta rishikojnë qëndrimin e tyre", u shpreh ky përfaqësues i protestuesve.



kompetenca ekzekutive.

Idenë e formimit të tij e kanë kundërshtuar edhe qeveritë e kaluara, duke e konsideruar si një mekanizëm që mund t'i sjellë telashe Kosovës, pasi do të kishte qasje të plotë në fushat e zhvillimit ekonomik, arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar më 23 dhjetor të vitit 2015 se parimet e përgjithshme të Asociacionit, të dakorduara po atë vit në mes të Kosovës dhe Serbisë, nuk janë tërësisht në përputhje me frymën e Kushtetutës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese ka thënë se ky Asociacion mund të formohet

nëse parimet që nuk janë në harmonizim me Kushtetutën, harmonizohen. Serbia, në anë tjetër, këmbëngul që Asociacioni të formohet në bazë të marrëveshjeve të arritura.

Çfarë parasheh Asociacioni?

Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikohet që të mbledhë rreth vetes dhjetë

komuna në Kosovë të banuara me shumicë serbe: Mitrovicë e Veriut, Klokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë. Sipas marrëveshjeve, Asociacioni ka për qëllim t'i përfaqësojë interesat kolektive të këtyre komunave, veçmas në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë.

Marrëveshja e vitit 2013 për Asociacionin thekson se ai do të krijohet me statut dhe strukturat e tij mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Po ashtu,

thuhet se Asociacioni do të ushtrojë edhe përgjegjësi të tjera shtesë, varësisht se si delegohen nga autoritetet qendrore dhe që do të ketë një rol përfaqësues tek autoritetet qendrore.

Sipas marrëveshjes ë vitit 2015 për parimet për krijimin e Asociacionit, objektivat kryesorë të Asociacionit janë: ushtron vështrimin e plotë për zhvillimin e ekonomisë lokale; ushtron vështrimin e plotë në fushën e arsimit; ushtron vështrimin e plotë për përmirësimin e shëndetësisë lokale primare e sekondare dhe përkujdesjen sociale; ushtron

vështrimin e plotë për koordinimin e planifikimit urban dhe rural; aprovon masa për përmirësimin e kushteve lokale të jetesës për të kthyerit në Kosovë; zhvillon, koordinon, lehtëson aktivitete hulumtuese dhe zhvillimore; promovon, shpërndan, dhe avokon për çështjet me interes të përbashkët të anëtarëve të tij dhe i përfaqëson ata përfshirë tek autoritetet qendrore; vendos marrëdhënie dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi me asociacionet e tjera të komunave, vendore dhe ndërkombëtare etj.

Përkujtohen heronjtë Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha

EPOKA E RRE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 JANAR - Përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe liderë partish kanë përkujtuar heronjtë Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha në 26-vjetorin e rënies.

Kryeministri Albin Kurti, bashkë me presidenten e vendit Vjosa Osmani-Sadriu, zëvendës-kryeministren Donika Gërvalla Schwarz, bënë homazhe te shtatorja e heroit Zahir Pajaziti në 26-vjetorin e rënies së heronjve Pajaziti, Zejnullahu dhe Hoxha. "Duke kujtuar e përkujtuar komandantin Zahir Pajaziti dhe dëshmorët e tjerë të kombit, në të njëjtën kohë ne tregojmë se sa i madh ishte çmimi për lirinë tonë, për shtetin tonë, për pavarësinë tonë dhe se sa i vlefshëm për të tashmen dhe të ardhmen është ky kujtim e ky përkujtim që bëhet si nga institucionet, po ashtu edhe nga qytetarët e vendit tonë", ka deklaruar Kurti. Ai ka theksuar se Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha ishin kushtrimi për luftë çlirimtare, njëkohësisht ishin edhe pararendës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës meqenëse ata kryenin aksione çlirimtare edhe para se të fillonte lufta.

Edhe anëtarë të kryesisë, deputetë dhe zyrtarë të Partisë Demokratike të Kosovës, kanë bërë homazhe para shtatores së heroit Zahir Pajaziti në Prishtinë. "Zahir Pajaziti, pushka e parë e lirisë, ra për të mos vdekur kurrë më 31 janar të vitit 1997, së bashku me dy heronjtë e tjerë e të paharruar të vendit tonë, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha. Lavdi të përjetshme trimave të Kosovës!", kanë theksuar zyrtarët e PDK-së. Gjithashtu, edhe zyrtarë të lartë të AAK-së kanë bërë homazhe pranë shtatores së heroit Zahir Pajaziti në kujtim dhe nderim të 26-vjetorit të rënies së tij dhe bashkëlufetarëve të tij, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha.

Ish-komandanti i UÇK-së, Lahi Brahimaj, pas homazheve ka rrëfyer ngjarje të rëndësishme nga lufta duke e cilësuar Zahirin si njeri i veprimit dhe aksionit. "Me Zahirin kishim takime të rregullta, si dy anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Herën e fundit e takova një javë para rënies. Ai ishte me Nait Hasanin e unë me bashkëlufetarët Myrtë Zeneli, Naser Brahimaj, Hajdar Ahmeti dhe Hysen Brahimaj. U takuam te Kodra e Becit, më pas



vazhdova me Zahirin e Naitin për në Ponoshec, për t'u kthyer më pas në Jabllanicë. Aty na pritën nëna Azë me bukë e çaj. Ishte ky takimi i fundit me heroin, të cilit në periudha të tjera të luftës për liri, iu bashkuan edhe heronjtë Myrtë Zeneli dhe Naser Brahimaj", ka deklaruar Brahimaj, duke shtuar se Zahirin ishte njeri i veprimit dhe aksionit.

"Ashtu i edukonte edhe bashkëlufetarët e tij, për më pak fjalë e më shumë veprime në favor të arritjes së lirisë. Ashtu edhe ra. Heroikisht në luftë me armikun deri në plumbin dhe frymën e fundit", ka thënë Brahimaj.

Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, i shoqëruar nga nënkryetarja Marigona Lahu,

kryesuesi i Kuvendit, Hilmi Hoxha, nga drejtorë, asamblistë, shoqata të dala të luftës e qytetarë, në 26-vjetorin e rënies së tre dëshmorëve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha, kanë bërë homazhe pranë kompleksit memorial të komandantit të UÇK-së, Zahir Pajaziti, në Orllan, pasta homazhe janë bërë edhe në "Kompleksin Memorial të Dëshmorëve" në Penuhë si dhe te shtatorët e katër dëshmorëve në qytet.

Me këtë rast kryetari Bulliqi ka përkujtuar heroizmin dhe luftën e shenjtë për liri të Zahir Pajazitit me shokë. "Guximi dhe sakrificat e Zahirit me shokë, me përpjekjet e tyre dhe luftën e pakompromis, trasuan një rrugë të gjatë drejt lirisë, në të cilën u bashkua një popull i tërë që nuk e duronte nënshtrimin, por luftonte e sakrifikon deri në vetëmohim për liri", ka thënë Bulliqi.



Në Kosovë strehohen katër gazetarë afganë

PRISHTINË, 31 JANAR (ER) - Gazetarët afganë Amina Omid, Ahmad Shaker, Nimatullah Gholami dhe Raifullah Nikzad, të shoqëruar nga kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha dhe Zyrtarja Ligjore e European Centre for Press and Media Freedom ECPMF, Flutura Kusari, kanë mbajtur sot konferencë për medie.

Në konferencën e mbajtur në zyrat e AGK-së, gazetarët afganë janë shprehur mirënjohës për mbështetjen e dhënë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe gatishmërinë e ECPMF-së dhe AGK-së për t'i ndihmuar ata. "Falënderoj Qeverinë e Kosovës dhe Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës që na kanë krijuar këtë mundësi që të jemi në Kosovë dhe që ta vazhdojmë profesionin tonë të sigurt", ka pohuar Omid, duke shtuar se

shpreson që të gjithë gazetarët e Afganistanit, veçanërisht vajzat dhe gratë, të jetojnë në liri të plotë ashtu siç jetojnë në Kosovë.

Teksa gazetari Ahmad Shaker ka thënë se shumë prej kolegëve të tij janë kërcënuar me jetë dhe se shumë prej tyre janë detyruar të ikin në shtetet e tjera. "Afganistanin e kemi lënë në gjendje të rëndë, mediet atje nuk janë aspak të lira dhe secila medie ka një përfaqësues të talebanëve që i kontrollon. Ata vërtet e kanë krijuar një gjendje të pasigurt sepse nuk pranojnë asnjë kritikë ndaj pushtetit. Përafërsisht 60 për qind e medieve janë mbyllur dhe gazetarët e kanë lëshuar shtetin. Një pjesë e atyre gazetarëve janë strehuar në shtetet afër Afganistanit, por që po jetojnë një jetë mjaft të varfër", ka thënë



ai. Më tej, gazetari Raifullah Nikzad ka pohuar se është shumë i lumtur që gjendet në Kosovë, njëkohësisht është shumë i shqetësuar për familjen e tij që ka mbetur në Kabul. "Nga

mediet dhe gazetarët e Kosovës ju kërkoj ta trajtojnë më shumë gjendjen e Afganistanit dhe kolegëve të tyre atje, që t'u ndihmojnë atyre ta ushtrojnë profesionin e tyre lirshëm", ka theksuar Nikzad.

Kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha, u shpreh i lumtur për ndihmën e dhënë nga shteti për strehimin e gazetarëve afganë në Kosovë, teksa falënderoi edhe kolegët për solidarizimin me ta. "AGK-ja është shumë e lumtur që të ndihmojë në strehim gazetarët afganë, që janë detyruar të ikin nga shteti i tyre për shkak të situatës politike. Jam falënderues për solidarizimin e komunitetit gazetaresk me ta dhe ne do të bëjmë gjithçka që mundemi që ata të vazhdojnë ta bëjnë punën e tyre si gazetarë në një ambient të sigurt", ka thënë Rexha.

Flutura Kusari, zyrtare ligjore në ECPMF, teksa shpjegoi programin dhe benefitet e tij, tha se do të bëhet çdo gjë që kolegët afganë ta vazhdojnë punën e tyre si gazetarë.

Konjufca priti në takim lamtumirës ambasadorin e Turqisë në Kosovë

PRISHTINË, 31 JANAR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Turqisë në Kosovë, Çağrı Sakar, me rastin e përfundimit të mandatit të tij.

Konjufca e falënderoi ambasadorin Sakar për

bashkëpunimin e frytshëm dhe kontributin e tij në thellimin e marrëdhënieve dypalëshe.

Po ashtu, Konjufca ka shprehur mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme të Republikës së Turqisë ndaj Republikës së Kosovës në proceset e

shtetndërtimit dhe fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar.

Në takim u vlerësuan të shkëlqyera raportet e deritashme dhe u ritheksua gatishmëria e dyanshme për avancimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët.



Von Cramon ia dorëzon Parlamentit Evropian draftraportin për Kosovën

PRISHTINË, 31 JANAR - Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon - Taubadel, ka dorëzuar draftin e raportit të saj vjetor për Kosovën, për të cilin do të diskutohet fillimisht në Komisionin për Politikë të Jashtme, ndërsa më vonë gjatë vitit edhe në seancë plenare.

Ky tekst përmban pikat e përgjithshme, ngjashëm me raportet e viteve të shkuara, por merr parasysh edhe zhvillimet që kanë ndodhur ndërkohë. Në këtë draftraport Parlamenti Evropian "mirëpret aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE, që reflekton orientimin proevropian të qytetarëve të saj dhe përcaktimin e qartë gjeopolitik".

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit të kaluar, kur Çekia kryesonte bllokun, ndërsa tash Presidenca suedeze është duke u konsultuar me vendet anëtare për hapat e mëtejme, raporton REL.

Në draft thuhet, po ashtu, se "mirëpritet marrëveshja e shumëpritur për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës". Parlamenti Evropian ka insistuar për shumë vjet që liberalizimi i vizave të bëhet sa më shpejt.

Në fund të vitit 2022 vendet anëtare të BE-së më në fund kanë arritur pajtueshmëri për ta finalizuar procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ky vendim pritet të hyjë në fuqi në janar të vitit 2024.

Thirrja për njohjen e pavarësisë së Kosovës nga të gjitha vendet anëtare të BE-së që Parlamenti Evropian e përsërit secilin vit në raportet për Kosovën - është përfshirë në tekst edhe kësaj radhe. "Ftohen vendet anëtare që nuk e kanë njohur ende Kosovën si shtet sovran që ta bëjnë një gjë të tillë".

Sa i përket situatës në Kosovë



thuhet se vendi ka pasur një periudhë të stabilitetit politik pas zgjedhjeve të vitit 2021 dhe në draft u bëhet ftesë autoriteteve të Kosovës që të ndërmarrin më shumë veprime për t'u përballur me sfidat në rrugëtimin evropian.

Edhe këtu përsëritet se "dinamika e procesit të integritetit do të varet nga progresi në sundimin e ligjit, të drejtave themelore, dhe normalizimin e raporteve me Serbinë".

Parlamenti Evropian përsëritet përshtatjen e Kosovës me qëndrimet e BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë, sidomos dënimin e ashpër të agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës dhe zbatimin e sanksioneve ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë.

Ky institucion mbështet edhe aplikimin e Kosovës për

anëtarësim në Këshillin e Evropës dhe planin e vendit për t'u përfshirë në programin e partneritetit për paqe të NATO-s. Në këtë tekst përsëritet, po ashtu, përkushtimi për luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, por shprehet shqetësim për gjendjen e gjyqësorit në Kosovë që, sipas tekstit, "vazhdon të jetë joefikas dhe i ndjeshëm ndaj ndërhyrjes së panevojshme politike".

Në raport shprehet keqardhje për ndikimin negativ që ka pasur atmosfera e polarizimit politik në punën e Kuvendit dhe u bëhet ftesë deputetëve të opozitës që t'i japin fund praktikës së abstenimit.

Sa i përket lirisë së shprehjes në Kosovë, në tekst thuhet se në Kosovë "ka një mjedis të gjallë pluralist medial", por ka shqetësim për fushata të sulmeve ndaj gazetarëve

hulumtues. Në veçanti shqetësim shprehet për mungesën e lirisë së shprehjes në veri të Kosovës dhe dënohen ashpër sulmet ndaj gazetarëve në komunat veriore.

Në tekst bëhet thirrje edhe për një angazhim të sigurt të Qeverisë së Kosovës dhe përfaqësuesve të serbëve të Kosovës për një dialog i cili do ta forconte besimin e ndërsjellë.

Sa i përket dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, përsëritet thirrja që të dyja shtetet të angazhohen në frymën e kompromisit për të arritur "një marrëveshje gjithëpërfshirëse, ligjrisht obliguese për normalizimin e raporteve të bazuar në njohjen e ndërsjellë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare".

Po ashtu, bëhet thirrje edhe për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura deri

me tani në dialog, përfshirë edhe atë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Më tutje, në tekstin e draftraportit për Kosovën dënohen edhe tensionet në veri të vendit. Por, mirëpritet pjesëmarrja e Kosovës në nismat rajonale dhe përsëritet edhe marrëveshjet e arritura në kuadër të Procesit të Berlinit.

Nga BE-ja kërkohet që të dinamizohet procesi i zgjerimit, duke e quajtur këtë si politikën më të suksesshme të BE-së për ndërtimin e paqes dhe stabilitetit në rajon dhe në Evropë.

Deputetët e Parlamentit Evropian do të kenë mundësi që t'i paraqesin amendamentet e tyre në këtë raport. Pas kësaj, do të votohet edhe për amendamentet dhe për raportin në tërësi.

Procedohet për në seancë plenare Projektligji për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar

Prishtinë, 31 janar - Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes ka mbajtur mbledhjen e radhës e cila është kryesuar nga Bekë Berisha, kryetar i komisionit, ku u shqyrtua raporti me

rekomandime për Projektligjin për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Me këtë rast, kryetari Berisha sqaroi se ky projektligj ka kaluar të gjitha procedurat nëpër komisionet përkatëse,

ndërkaq në vijim u miratua nga anëtarë të komisionit dhe procedohet në seancë plenare. Komisioni në vazhdim ka mbajtur takim të mbyllur për të diskutuar edhe çështje të tjera



Kosova e Suedia theksojnë nevojën e rritjes së bilancit tregtar ndërmjet dy vendeve

PRISHTINË, 31 JANAR - Ministria e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka pritur në takim ambasadorin e Suedisë, Jonas Westerlund, gjatë të cilit takim kanë diskutuar rreth fushëveprimtarisë së Ministrisë së Ekonomisë si dhe prioriteteve që ME-ja ka në plan afatshkurtër dhe

afatgjatë. Ministria Rizvanolli e ka njoftuar ambasadorin Westerlund për sektorin e ICT-së, që konsiderohet si një ndër sektorët me më shumë rëndësi si në aspektin e zhvillimit ekonomik, po ashtu për zhvillimin e kuadrove të reja profesionale.

Ndërmjet ministres dhe ambasadorit u diskutua për nevojën e rritjes së bilancit tregtar ndërmjet dy vendeve, ku u dakorduan që të shikohen mënyra për t'i stimuluar kompanitë suedeze për investim në sektorë të ndryshëm dhe bashkëpunim më të madh ekonomik.



Miratohet raporti i komisioneve për Byronë Shtetërore për Verifikimin e Pasurisë



PRISHTINË, 31 JANAR - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ka miratuar raportin e komisioneve kryesore për Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Për të kanë votuar gjashtë deputetë të mazhorancës, kurse opozita është përmbajtur nga votimi. Megjithatë, vërejtje për këto raporte ka adresuar anëtari i komisionit, deputeti Driton Selmanaj, i cili ka thënë se aty ka

vlerësime abstrakte për byronë. "Është ndoshta prej herëve të para kur shoh vlerësime abstrakte ose kuturu të komisioneve. Në komisionin për buxhet thuhet se Projektligji për Byronë përmban kosto shtesë buxhetore, por e përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Çka është ky vlerësim kështu? Çka është e përballueshme për buxhetin e Kosovës dhe çka jo? Gjithmonë çdo projektligj që ka ardhur këtu është përcaktuar qartë sa është kostoja buxhetore e këtij projektligji, madje është ndarë për vitet

vijuese në mënyrë që të dihet qartë pasi janë paratë e taksapaguesve. Te rekomandimi tjetër i komisionit për integritet evropian, thotë se Projektligji për Byronë nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Ky është një vlerësim shumë i përgjithshëm, a ka rregullore ose direktiva të BE-së që e rregullojnë këtë çështje. Mendoj se nuk ka, por në të kaluarën ka ndodhur se kjo çështje nuk është e rregulluar me direktiva të BE-së dhe ne mund të ecim tutje", ka thënë Selmanaj.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Adnan Rustemi, ka thënë se këto vlerësime janë të komisioneve të tjera për të cilat nuk mund të komentojë të njëjtat. "Këto vlerësime janë ndërtuar si shabllone preventive minimale të komisioneve të përherëshme. Esencialisht nuk po arrijmë të lëshohemi në thelb të çështjeve që kemi përgjegjësi, deri-diku është e kuptueshme. Por kjo nuk t'i dërgojë nga ekstremi në ekstrem tjetër, nëse nuk është e mundur të bëhet vlerësim sa më substancial, kjo nuk do të thotë që të kemi vlerësim

sipërfaqësor. Komisioni për buxhet në rastin konkret do të ishte me rëndësi të na konstatojë që buxheti është planifikuar këtë vit për këtë byronë", ka theksuar deputeti Rustemi. Po në këtë mbledhje është miratuar edhe raporti i punës për vitin 2022, si dhe është themeluar një grup punues për t'i shqyrtuar CV-të e kandidatëve për drejtor dhe zëvendës drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, të propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Bankat e Eurozonës shtrëngojnë dhënien e kredive

Prishtinë, 31 janar - Bankat e Eurozonës kanë shtrënguar qasjen në kredi për kompanitë që nga kriza e borxhit të vitit 2011 dhe presin të vazhdojnë ta bëjnë këtë. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet dhe familjet ra gjithashtu me rënien e kërkesës për kredi hipotekare që është më e madhja në

histori si pasojë e normave më të larta të interesit dhe besimit më të ulët. Rezultatet mund të jenë në dobi të politikëbërësve të BQE-së duke bërë rastin për rritje më të vogla të normave në muajt e ardhshëm. 26 për qind e bankave të anketuara nga BQE thanë se i bënë më të rrepta standardet

e tyre për miratimin e kredive për kompanitë në tremujorin e fundit të vitit të kaluar, shtrëngimi më i madh që nga viti 2011. Standardet e kredisë u shtrënguan edhe për kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekare, një tendencë që bankat presin të vazhdojë këtë tremujor.



Arti i të bërit pyetjet e duhura



Nga Kevin DIKINSON

Shumë njerëz, përfshirë edhe mua, mund t'iu duket e frikshme bërja e pyetjeve. Pasi kjo gjënxit tek ne shqetësime dhe dyshime për veten, sikur akti i të qenit kureshtar të jetë një pranim tepër publik i padijes sonë.

Fatkeqësisht, bërja e pyetjeve mund të na motivojë të gjejmë ngushëllim tek përgjigjet – pavarësisht se sa i lëkundur mund të jetë kuptimi ynë mbi faktet – në vend se të rrezikojmë të dukemi budallenj para të tjerëve apo edhe ndaj vetes. Por një herë e një kohë, ne të gjithë ishim dijetarë që shtronim pyetje.

Filluam t'i ngacmonim me pyetje prindërit tanë që kur ishim të vegjël, madje edhe në moshën parashkollore, teksa ku u rritëm kërkimet tona epistemike hodhën themelet e shkencës, filozofisë dhe rendit shoqëror. Ku fshihet Dielli natën? Si ndodh që hallkat e zinxhirit qëndrojnë të lidhura së bashku? Pse ai njeriu atje nuk ka një shtëpi si ne? Pse gurët fundosën, ndërsa akulli noton? A është e njëjtë bluja që shihni ju me atë që shoh unë?

Ndërsa është menduar prej kohësh se arsyetimi i shoqëruar me një listë të pafundme pyetjesh nga fëmijët, ishte një strategji e tyre për të kërkuar vëmendje, studimet e fundit sugjerojnë se fëmijët janë vërtet kureshtarë, dhe se pyetjet e tyre ndikojnë tek të menduarit e tyre të mëvonshëm.

Pastaj, në një moment, zhduket nxitja jonë për të bërë pyetje. Dhe ky është një problem sepse siç thotë gazetari Uorren Berger: "Në një kohë kur ka kaq shumë informacione rreth nesh, dhe

përgjigjet janë në majë të gishtave tanë, ne kemi nevojë për pyetje të mëdha, në mënyrë që të mund të dimë se çfarë të bëjmë me gjithë këtë informacion dhe të gjejmë rrugën drejt përgjigjes tjetër".

Asnjëra prej tyre nuk përbën një shkak për të qenë disfatistë. Pavarësisht nga mosha jonë, arti (dhe aftësia) për të bërë pyetjen e duhur nuk është as i vdekur dhe as i humbur. Në rastin më të keq, ai thjesht është i përgjumur, dhe ne duhet të gjejmë mënyra për ta rigjallëruar atë.

Mbështesni një mjedis kureshtar

Po pse zbehet impulsi i fëmijëve për të bërë pyetje kur ata rriten? Përgjigja për këtë varion, por unë mendoj se një faktor i rëndësishëm, është se si ndryshojnë mjediset shoqërore që na rrethojnë ndërsa rritemi. Shkollat transformohen nga vendi ku bëhen pyetje, në një vend të financiar nga aftësia jonë për t'iu përgjigjur atyre.

Ne mësojmë ta shesim veten në tregun e punës nga ajo që dimë, dhe jo nga ajo që nuk dimë. Dhe e pranojmë se shoqëria i shpërblen njerëzit që premtojnë se kanë përgjigjet, pavarësisht se sa të largëta mund të zgjidhet që propozojnë ata. Ndaj një mënyrë për të rigjallëruar kureshtjen tonë, është thjesht ndryshimi i skenarit. Ne mund të jemi më të guximshëm për të bërë pyetje në publik, si dhe për t'i inkurajuar të tjerët që të ndjekin kuriozitetin e tyre. Në këtë mënyrë ne ndihmojmë në krijimin e një mjedisi ku ata përreth nesh ndihen të sigurt nga turpi dhe

poshtërimi që mund të ndiejnë në zbulimin e mungesës së njohurive mbi një temë.

"Në një botë që qeveriset nga turpi dhe ndoshta dhe korrektësia politike, ka gjithnjë e më shumë njerëz që nuk po thonë atë që kanë në mendje. Ata nuk po pyesin atë që kanë në mendje. Dhe këtu pyetjet janë më të fuqishmet" – tha në një intervistë sipërmarrësi Tim Ferris.

Bëni pyetjet e duhura

Në një moment të caktuar, ne të gjithë kemi pasur një mësues, prind ose menaxher që na thotë: "Nuk ka pyetje idiote". Por vetëm sepse një pyetje nuk mund të jetë idiote, nuk do të thotë se ajo nuk mund të jetë e çuditshme, sarkastike, përcmuese, shpërfillëse apo e keqe. Këtu qëndron edhe vija ndarëse midis një pyetjeje "të drejtë" dhe "të gabuar".

Qëllimi i një pyetje të gabuar, nuk është eksplorimi apo shuarja e kuriozitetit. Por fitimi nënjë debat apo detyrimi i dikujt për të dhënë një informacion që tashmë e dini. Me pak fjalë, nëse po bëni një pyetje si avokat, jeni në rrugë të gabuar. Një pyetje e drejtë është çdo pyetje që ju gjallëron, që buron nga kurioziteti i sinqertë dhe që siç vëren Berger, ju ndihmon të organizoni të menduarit rreth asaj që nuk dini.

Kthehuni tek bazat

Ne kemi zakonet e keq të mbivlerësimit të njohurive tona për çdo temë të caktuar. Ky iluzion, mund të çojë në supozime dhe besime të rreme që i "infektojnë" proceset tona të të menduarit. Një

nga mënyrat për të hequr dorë nga ky zakon, është të fillojmë me pyetjen më themelore që mund të formulojmë.

Artisti konceptual Xhonaton Kits i quan "pyetje naive". Ndërkohë gjeokimisti Houpp Jahren i quan "pyetje kurioziteti". Cilado qoftë etiketa, ato janë në thelb lloji i pyetjes që mund të bëjë një fëmijë. Përfitimi nga pyetje të tilla, kërkon që ne të gërmojmë më thellë dhe të ngadalësojmë të menduarit tonë, gjë që nga ana tjetër, mund të na zbulojë të panjohura ose informacione që mund të na kenë shpëtuar herën e fundit që kemi eksploruar mbi këtë temë. Thelbi është se të qenit kurioz, na ndihmon të lidhemi me të tjerët, dhe kjo lidhje na bën më të angazhuar me jetën.

Praktikoni të bërit e pyetjeve

Gjërat kryesore janë ndershmëria dhe kurioziteti. Elison Bruks dhe Lezli K.Xhon, përkatësisht profesoreshë e asociuar dhe profesor i administrimit të biznesit, rekomandojnë disa praktika më të mira. Ata ju këshillojnë që bëni pyetje më pak të ndjeshme, të favorizoni pyetjet e njëpasnjëshme, t'i mbani pyetjet të hapura, të angazhoheni me një ton të rastësishëm, t'i kushtoni vëmendje dinamiksë së grupit, dhe natyrisht të dëgjoni me vëmendje.

"Lajmi i mirë është se duke bërë pyetje, ne e përmirësojmë natyrshëm inteligjencën tonë emocionale, gjë që nga ana tjetër na bën pyetës më të mirë" – shkruajnë ata në Harvard Business Review. Këto sugjerime do t'ju

shërbejnë shumicën e kohës, por Bruks dhe Xhonparalajmërojnë se ka disa rrethana kur ato nuk do të jenë të zbatueshme (si p.sh. gjatë negociatave intensive, por edhe nëse jeni në profesion avokat).

Po ashtu ju mund të praktikoni bërjen e pyetjeve për veten tuaj. Ferris rekomandon mbajtjen e një liste pyetjesh në një ditar. Ato mund të jenë vetë-reflektuese, të nxisin planet për të ardhmen ose mund të jenë thjesht mendime kur jeni të nervozuar dhe zemëruar.

Ferris thotë se edhe nëse 90 për qind e pyetjeve tuaja të ditarit janë koti, edhe nëse ia vlen tëndiqen vetëm 10 për qind tyre, kjo është një shkallë e madhe suksesi. Pasi i inkurajon njerëzit të gjejnë kohë për të bërë pyetje fantastike absurde: Si do ta realizonit punën e një jave brenda 2 orësh? Çfarë do të bënit nëse do të fitonit lotarinë? Nëse do të mund të projektonit një qytet nga e para, si do ta bënit? Nëse do ta dinit ditën kur do të vdisnit, si do ta ndryshonte kjo jetën tuaj sot?

"Këto lloj pyetjesh absurde ju detyrojnë të shkelni disa nga kufijtë në sferën e rehatisë që keni krijuar për veten, dhe kjo është ajo që i bën kaq të fuqishme" – thotë Ferris. Përtej gëzimit të zbulimit, dijeni se pyetjet që bëni janë problemet që zgjidhni. Ato ju ndihmojnë të lidheni me të tjerët dhe t'i forconi ato marrëdhënie.

Dhe ato janë gjithashtu mjetet tuaja kryesore për të mësuar rreth botës tuaj, si ajo e jashtme që ju rrethon, ashtu edhe ajo e brendshme brenda jush. Pra bërja e pyetjeve, është mënyra më e mirë për të thelluar të kuptuarit tuaj mbi gjërat që kanë rëndësi për jetën tuaj. / "Big Think" – Bota.al

DËSHMORI I KOMBIT RESHAT YMERI SIMBOL I RËNIES PËR KOSOVËN E LIRË



Ismet SYLEJMANI

Fillimi i vitit 1990, do të mbahet gjatë në mend në kujtesën e popullit tonë në Gjilan!

Historia do të dëshmojë, se në atë vit në Gjilanin heroik të Rexhep Males, të Kadri Zekes, të Nuhi Berishes, të Zija Shemsiut, të Rexhep Elmazit, të Agim Rashitit e të Reshat Ymerit, Heronjë e Dëshmorë këta të periudhës së paraluftës të titanike të UÇK-së, populli shqiptar, i udhëhequr nga bijtë dhe bijat e tij më të mirë e më besnik, i kishte mbushur rrugët dhe sheshet e qytetit, dhe ashtu sikur në vitet 1968, 1981 dhe 1989, kërkonte të drejta e barazi, liri e Republikë për popullin shqiptar nën ish-Jugosllavi!

Pjesmarrja në demonstratë ishte masive e popullit të Gjilanit dhe e fshatrave!

Ishte tregues i qartë për Serbinë pushtuese, se në Kosovë po krijoheshin rrethana të tjera dhe të reja dhe ajo nuk do ta kishte të gjatë pushtimin e sajë në Kosovë! Demonstrata e viteve 1989 dhe 1990 në Gjilan, ishte tregues i

madh dhe shihej qartë se në udhëheqje të LPK-së në atë kohë, kishte ardhur një gjeneratë e re shqiptarësh të rinjë aktiv, që ishin vazhdues besnik të idealeve të mëdha e liridashëse të heronjve e dëshmorëve të kombit dhe të shokëve të tyre të gjallë, por që ishin burgosur dhe po dergjeshin burgjeve serbe dhe atyre nëpër ish-Jugosllavi!

KUR DHE SI U VRA DËSHMORI I KOMBIT RESHAT YMERI?

Dhjetë ditë më herët para se të vritej i pavdekshmi Reshat Ymeri, natën e 19 Janarit 1990, Këshilli i Rrethit të LPK-së për Gjilan, Viti dhe Kamenicë, e ka shpërndarë në Gjilan TRAKTIN e LPK-së!

Ky ishte TRAKTI i fundit që i drejtohej popullit shqiptar dhe opinionit të jashtëm, me rastin e mbajtjes së Kongresit të 14 të Jashtëzakonshëm të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë- LKJ, sepse LKJ më vonë u shua e Jugosllavia filloi të shpërbëhej! TRAKTI Kky dokument politik

ilegal kombëtar i LPK-së, ishte materiali që iu gjet në xhep, pas vrasjes nga policia pushtuese serbe, Dëshmorit të Kombit Reshat Ymeri!

Mbajtja në gji e TRAKT-it të LËVIZJES... nga Reshat Ymeri, në kohën kur po demonstrohej në të gjitha anët e qytetit, e veçanërisht në lagjen e Dardanisë (ish-Gavrani), nuk ishte e rastit, por ishte dhe mbetet dëshmi se sa të vetëdijshëm e morri plumbi i armikut atë djalë të ri, para 33 viteve, më 29 Janar 1990!

Gjilani i 29 Janarit të vitit 1990, ishte një nga qytetet e shumta të Kosovës që jehonte fuqishëm me thirrjet duam liri, duam të drejta, duam Republikë për Kosovën, gjëmonin fuqishëm!

Ato kërkesa legjitime dhe demokratike që kërkoheshin nga populli shqiptar në atë kohë atëherë, në vend të përgjigjes së drejtë, ato ranë në vesh të shurdhër, ndërsa ne që i kërkonim ato në rrugë, pra të drejtat e popullit të Kosovës, shtypeshim dhe vriteshim, kundër neve hidhej gazë lotsjellës mbi normat e lejuara, goditeshim

e gjakoseshim, madje edhe vriteshim!

Në vijat e para me forcat e errëta të Serbisë pushtuese dhe me veglat e saj në Kosovë, e mori plumbi i armikut, afër postës së vogël të shkollat e mesme në Gjilan, bshkëdemonstruesin tonë të radhëve të para, Dëshmorin e Kombit Reshat Ymerin!

Pas rënies së Reshatit, në Gjilan ishte krijuar një atmosferë e zymtë!

Atmosferë vrsjeje, atmosferë e derdhjes së gjakut!

Por mbi supet tona të udhëheqjes së LPK-së të Këshillit të Rrethit, si organizatorë të demonstratës që ishim, u shtua edhe më shumë përgjegjësia!

Gjakun që e derdhi Reshati në rrugët e Gjilanit, plagosjet dhe rrahjet që na ishin bërë, na obligonin edhe më shumë ta vazhdonim luftën edhe më me forcë, dhe që atëherë filluam të mendonim se luftën duhet ta vazhdonim, por edhe duhej ta kombinonim edhe me forma të tjera, sepse shihej që nuk shkonte më ashtu!

Ne me gurë, e ata me plumba, ne me brohoritje e ata me gazlotsjellës, me rrahje, me armë e vrasje!

Përcjellja e fundit e Dëshmorit të Kombit Reshat Ymeri, ndonëse e penguar dhe e shtyrë për në orët e vona të pasditës, me qëllim që të mos ishte me shumë njerëz, megjithatë pjesmarrja ishte e madhe dhe ishte masive prezenca e popullit!

Dhembja për rënien e dëshmorit Reshat Ymeri, ishte padyshim shumë e madhe!

Reshat Ymeri iu shtua zingjirit të artë të të rënëve për Atdhe, dhe rënditja përkrah heronjve e dëshmorëve të kombit, Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Zija Shemsiu, Rexhep Elmazi e Agim Rashiti ishte e jashtëzakonshme, ashtu sikur e jashtëzakonshme dhe heroike, ishte edhe zgjatja e këtij zingjiri të florinjte nga Heronjtë dhe Dëshmorët e UÇK-së!

Lavdi Dëshmorit të Kombit Reshat Ymeri!

Prishtinë, 29 Janar, 2023

ALI AHMETI UNË JAM ME TY



Ismet SYLEJMANI

Unë jam me Ali Ahmetin, por jam edhe me të gjithë ata, me të cilët është Ali Ahmeti!
Natyrisht nuk jam me ata, të cilët nuk janë me Ali Ahmetin, përkundrazi jam kundër tyre!
Unë jam me ata të cilët e duan Ali Ahmetin, jam kundër atyre që nuk e duan Ali Ahmetin!
Unë nuk jam me ata të cilët e duan Ali Ahmetin, por nuk i dua ata të cilët i don Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin

dhe të mos i duash ata që i don Ali Ahmeti!
Ali Ahmeti është themelues i UÇK-së, UÇPMB-së, UÇK-së dhe BDI-së!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër UÇPMB-së që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër BDI-së që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër BDI-së që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar Ali Ahmeti!
Nuk mund ta duash Ali Ahmetin e të jeshë kundër Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar Ali Ahmeti!

ka themeluar Ai!
Është broçkull, të thuash e dua Ali Ahmetin, por jo UÇPMB-në që e ka themeluar Ai!
Është super broçkull, të thuash e dua Ali Ahmetin, por jo Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare që e ka themeluar dhe komanduar Ai!
Është TOP broçkull, të thuash e dua Ali Ahmetin, por jo BDI-në që e ka themeluar dhe është Kryetar Ai!
Nuk ka qenë mundur ta duaje Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare e të mos ia keshë dashur Asaj Komandantin e pergjithshëm dhe të mos ia zbatoje urdhërin ose edhe të ia refuzojë urdhërin Atij!
Nuk është e besueshme të thuash unë e dua BDI-në më shumë se kryethemeluesi i sajë Ali Ahmeti, sepse atëherë i bjen se ti je më katolik se Papa!
Është broçkull me marifet, të

thuash e dua Ali Ahmetin, por nuk e dua atë që e ka bërë me vetëdije Ai, të cilën edhe kur ti ia kritikon, herë fshehtas e herë publikisht, Ai atë e mbronë me forcë dhe nuk pendohet!
Është reaksionare, është anakronike dhe për më tepër është antidemokratike por edhe antinjerëzore, të thuash Ai pra Ali Ahmeti është i mirë vetëm kur të përkdhelë e kur të lavdëron, por jo edhe atëherë kur ta merr, e nuk ta jep atë që nuk të takon se është e tepërt, nuk të përkdhelë, por të ndëshkon se është e gabuar, dhe të kritikon e nuk të lavdëron se nuk është e merituar!
Unë jam me Ty Ali Ahmeti!
Ali Ahmeti, unë jam me Ty, sikur gjatë tërë aktivitetit politiko-patriotik ilegal!
Ali ahmeti, unë jam me Ty, sikur gjatë gjithë luftës së armatosur ushtarake çlirimtare në Kosovë!

Ali Ahmeti, unë jam me Ty, sikur gjatë gjithë luftës së armatosur ushtarake çlirimtare në Luginë të Preshevës!
Ali Ahmeti, unë jam me Ty, sikur gjatë gjithë luftës së armatosur ushtarake çlirimtare në Maqedoninë e Veriut!
Ali Ahmeti unë kamë qenë dhe jam me Ty, në të gjitha betejat që i ke zhvilluar dhe ke fituar në të gjitha ciklet zgjedhore, prej kur e ke themeluar BDI-në, sot e gjithmonë, kurdoherë me Ty deri ne vdekje!
Jam me të gjithë ata që Ti i don, me ata që Ti i mbronë dhe që i përkrahë Ti!
Të gjithë ata që nuk janë me Ty e që janë kundër Teje, unë nuk i dua!

Prishtinë, 30 Janar 2023



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

KOK-u kthen futbollin në kategorinë A

PRISHTINË, 31 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës e ka publikuar të martën kategorizimin e sporteve, sportistëve dhe të trajnerëve për vitin 2023. Shtëpia e sportit e Kosovës i ka ngritur

më së larti në këtë renditje sportin e xhudos dhe të futbollit në Kategorinë A. Në fakt futbollit është ngritur nga vendi i gjashtë në krye. "Me rekomandim të komisionit përkatës dhe miratim të

Bordit Ekzekutiv, Federata me dy medalje të arta olimpikë, ajo e Xhudos, dhe Federata më masive në vend, ajo e Futbollit, janë rekomanduar me maksimumin e pikëve, 100.

Kategorisë A i është shtuar boksi", ka njoftuar Komiteti Olimpik i Kosovës. Në kategorinë A janë edhe Federata e Hendbollit, e Volejbollit, e Basketbollit, e Karatesë dhe e Boksit.



Morina emërohet përzgjedhës i Përfaqësueses U17



Prishtinë, 31 janar - Trajneri i mirënjohur Arbnor Morina është emëruar përzgjedhës i ri i Përfaqësueses së Kosovës U17. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, e ka uruar Morinën për pozitën e re, duke i dëshiruar suksese në ciklin e ardhshëm kualifikues. Ai shpreson se përvoja dhe njohuritë e Morinës për futbollin do të kenë rol të rëndësishëm në krijimin e një ekipi sa më kompakt në këtë grupmoshë dhe do të jenë çelës i suksesit. Në anën tjetër, Morina falënderoi kryetarin e FFK-së për besimin e dhënë dhe u shpreh i gatshëm për ta dhënë maksimumin e tij që Përfaqësuesja U17 të ketë rezultate kulmore. "Puna e trajnerit është punë e cila nuk ka

pushim dhe nuk ka kufij. Jam i lumtur që jam kthyer aty ku kam qenë prej vitit 2000 deri në vitin 2005. Së bashku me stafin tim do të përpiqemi ta bëjmë më të mirën që duhet bërë për Kombëtaren U17. Jam i lumtur që po e pasoj Arsim Abazin, i cili është trajner i mirënjohur dhe miku im i vjetër. Do të punojmë shumë në atë drejtim që djemtë tanë t'i bindim që duhet të arrijnë rezultate kulminante, ngaqë i mbrojnë ngjyrat e Kombëtares së Kosovës", ka theksuar Morina. Përfaqësuesja e Kosovës U17 në kualifikimet për "Euro 2023" është përfshirë në Grupin e 9, ku bëjnë pjesë edhe Anglia, Kroacia dhe Ishujt Faroe. Ndeshjet e këtij grupi do të zhvillohen në Kroaci më 3, 6 e 9 nëntor.

Harris, MVP i javës në Superligë

PRISHTINË, 31 JANAR - Prince Caffë Superliga po vazhdon të dhurojë shumë sfida interesante. Basketbollisti më i mirë i kësaj jave ishte Jordan Harris i Vëllaznimit ndaj Ponte Prizrenit, ndeshje që shkoi në vazhdime. Ai kishte 35 pikë, katër kërcime e gjashtë asistime, duke pasur indeksin e ndeshjes 37, apo më të lartin e kësaj xhiroje dhe duke u shpallur MVP i javës. Harris realizoi dhjetë trepikësha nga 13 tentime dhe ishte më meritori që kuqezinjtë fituan ndaj prizrenasve. Trepça ia shkaktoi

humbjen e parë Golden Eagle Yllit pas 15 ndeshjeve në elitë, ku më meritorët ishin Andrew Gordon me 22 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime, si dhe Will Daniels me 15 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime. Bashkimi fitoi duelin ndaj rivales së vjetër, Pejës, ku u dallua basketbollisti shqiptar Daniel Lekndreaj me 16 pikë, 11 kërcime dhe një asistim. Ndërkohë, fitore të pritur realizoi Sigal Prishtina ndaj Rahovecit, ku më i miri ishte Brooks Debischop me 12 pikë, dhjetë kërcime e katër asistime.



Kosovën U17 e pret kampionat i rëndësishëm në Greqi

PRISHTINË, 31 JANAR - Hendbollistet e Përfaqësueses U17 të Kosovës në hendboll do të kenë një sfidë të rëndësishme në fund të muajit shkurt dhe fillim të muajit mars. Prej 26 shkurtit deri më 5 mars në Nafplio të Greqisë do të mbahet Kampionati i 16 Mesdhetar

për hendbollistet e grupmoshës U17. Pos Kosovës do të marrin pjesë edhe Algjeria, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi, Rumania, Spanja, Tunizia dhe Turqia. Kështu hendbollistet tona të reja do t'i presin ndeshje të forta, por shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre. Kosova

U17 grumbullohet më 23 shkurt në Kosovë, ndërsa udhëtimi për në Greqi planifikohet të bëhet tri ditë më pas. Ky do të jetë grumbullimi i tretë i kësaj gjenerate, që drejtohet nga kryetrajneri Mitat Ferati. Kosova U17 në verë do të paraqitet edhe në Evropianin e Divizionit B në Turqi.



Rossi: Pengu më i madh i jetës time është titulli i 10 kampion

ROMË, 31 JANAR - Ish-piloti italian i MotoGP, Valentino Rossi, ikona e këtij sporti, prej një viti është tërhequr nga garat. Ai e mbylli karrierën me 9 tituj kampionë bote në garat e motoçiklizmit, pa mundur dot të korrë edhe trofeun e 10 që e ndoqi për shumë vjet. Pikërisht ky është pengu i vetëm për Rossin: "Sa herë që

e mendoj titullin e dhjetë trishtohëm, pasi nuk arrita dot ta fitoj. Mendoj se e meritoja një titull të tillë duke u bazuar në nivelin dhe shpejtësinë që kam pasur në pistë". Rossi aktualisht konkurren në garat Endurance me makina. "Në dy sezone e humba titullin kampion në garën e

fundit të sezonit. Edhe për këtë arsye mendoj se e meritoja titullin e dhjetë në MotoGP. Ndoshta periudha që kalova me Ducatin me penalizoi në këtë drejtim, por nuk ndiej keqardhje për ato vite dhe vendimin që mora për të garuar aty. Nëse do të fitonim, do të shkruanim historinë", ka deklaruar Rossi.



Messi: Kupa e Botës plotëson karrierën time, do të doja të ma dorëzonte Maradona

PARIS, 31 JANAR - Lionel Messi dha intervistën e parë pas triumfit në Botërorin 2022 për gazetarin argjentinas Andy Kusnetzoff, duke pranuar se ishte një fitore që "mbyll rrethin" e karrierës së tij dhe rrëfeu se do të donte "Diego Maradona t'ia kishte dorëzuar trofeun". "E kisha thënë disa vjet më parë se e dija që Zoti do të ma jepte këtë dhuratë, se ai e kishte rezervuar për mua. Nëse do të kishte një moment që mund të zgjidhja se kur duhet ta fitoja do të ishte ky, siç ndodhi. Fitimi i Kupës së Botës plotëson rrethin e karrierës sime profesionale", është shprehur "ylli" argjentinas. Mungonte vetëm diçka, ose më mirë dikush, që të ishte gjithçka e përkryer: "Do të kisha dashur që



të ma jepte Diego Maradona kupën ose, të paktën, të ishte gjallë që të mund të më shihte. Argjentina sërish kampione bote, ai që e donte shumë kombëtaren". Në fund, Messi ka

shtuar: "E ndjeva mbështetjen e tij Diegos nga Parajsa. Pashë Kupën dhe ndjeva se po më thoshte 'ëja këtu, më merr', pashë sa shumë po shkëlqente në atë stadium të mrekullueshëm".

Lakersat pësojnë humbje nga Brooklyn

BROOKLYN, 31 JANAR - Fitorja e dytë radhazi për Brooklynin që synon t'i kapë majat në Lindje. Ekipi i Netsit imposhtoi me rezultat 121-104 rivalët e Lakersave, që luajtën pa LeBronin e Davisin. Për Brooklynin u dallua Irvingu me 26 pikë. Befason Orlando, që falë 29 pikëve të Bancheros, mundi me rezultat 119-109 Philadelphian jashtë fushës (Embiid 30 pikë e 11 rebounde). Fiton edhe ekipi kampion i Golden States, që mundi me



rezultat 128-120 Oklahoman. Stephen Curry lider në fushë për Warriorsin, autor i 38 pikëve e 12 asistimeve, mbështetur nga Klay Thompson me 28 pikë. Pas kohës shtesë fiton Sacramento (Fox 32 pikë), që mundi me rezultat 118-111 Minnesotan (Edwards 33 pikë). Ndeshje magjike e Luka Donçiqit, që

realizoi 53 pikë në fitoren e Dallasit, 111-105 ndaj Detroitit. Triumfon edhe Phoenixi, që mundi me rezultat 114-106 kanadezët e Torontos, me Bridges protagonist, autor i 29 pikëve. Ndërsa Washingtoni fitoi me rezultat 127-106 ndaj San Antonios, ndeshje ku diferencën në fushë Avdija me 25 pikë.

REZULTATET

Philadelphia - Orlando	109-119
Brooklyn - Lakers	121-104
Minnesota - Sacramento	111-118
Oklahoma - Golden State	120-128
San Antonio - Washington	106-127
Dallas - Detroit	111-105
Phoenix - Toronto	114-106
Portland - Atlanta	129-125

Mourinho krahason Osimhenin me Drogban

Trajneri i Romës, Jose Mourinho, ka bërë një krahasim në mes të Victor Osimhen dhe Didier Drogbas. "Ai është i të njëjtut nivel me

Drogban, por Didier nuk stimulonte. Nëse Victor ndryshon, atëherë OK. Do ta blija nëse do të isha në një klub me shumë para.

Megjithatë, nëse ai shkon në Angli një ditë, ai duhet të ndryshojë, sepse në Itali ata e durojnë këtë lloj sjelljeje, ndërsa në Premierligë ata do

ta ulnin ashpër atë", ka thënë Mourinho. "I thashë që ai shënoi një gol të mrekullueshëm dhe duhet të ndalojë aq shumë stimulimet.

Goli i tij ishte fantastik. Ai bëri të njëjtën gjë kur u takuam në fillim të këtij sezoni, kështu që ai është një lojtar fantastik", ka deklaruar Mourinho.

SHKURT

Lëndohet Erikseni, mungon tre muaj

Lajme të këqija për trajnerin Erik ten Hag, i cili ka mbetur pa Christian Eriksenin për tre muaj. Mesfushori danez u lëndua në një të këmbës gjatë ndeshjes së fituar të shtunën ndaj Readingut në FA Cup pas një dueli me Andy Carroll i cili u ndëshkua me karton të kuq pas dy të verdhëve. Klubi anglez njofton se, pas ekzaminimeve, ish-futbollisti i Tottenhamit e Interit duhet të qëndrojë jashtë fushës së blertë deri në fund të prillit ose në fillim të majit. Kështu, për futbollistin që shpëtoi mrekullisht në "Euro 2020" pas një sulmi kardiak, ky sezon thuhet se ka mbaruar pasi atij i nevojitet kohë për ta rikthyer formën optimale edhe pas rikthimit në fushën e blertë.

Isco, afër marrëveshjes me Union Berlinin

Isco është gati të nisë një aventurë të re, këtë herë në Bundesligë dhe si lojtar i Union Berlinit. Mesfushori spanjoll, ish-lojtar i Realit të Madridit, është afër arritjes së një marrëveshjeje me ekipin gjerman për pjesën e mbetur të sezonit, me opsionin për të rinovuar edhe për një vit. Union Berlini, i dyti në Bundesligë dhe në garë për titullin me Bayernin, prej ditësh po negocion me lojtarin dhe marrëveshja është afër finalizimit. Isco do të ketë një ekip të ri më shumë se një muaj pasi mediet spanjolle njoftuan largimin e tij nga Sevilla vetëm katër muaj pasi iu bashkua skuadrës andaluze të drejtuar nga Julen Lopetegui.

Jorginho mund t'i bashkohet Arsenalit

Mesfushori Jorginho mund t'i bashkohet Arsenalit. Chelsea duhet ta shkurtojë numrin e futbollistëve, shkruan "Goal". Fillimisht është raportuar se Conor Gallagher do të largohet nga Chelsea këtë muaj, megjithatë ai nuk dëshiron t'i bashkohet Evertonit. Tani mund të jetë mesfushori italian ai që do të largohet nga klubi londinez.

Kolo Muani: Ëndërr të luaj për Bayernin

Ecuria pozitive e Eintracht Frankfurtit në Bundesligë nuk ka se si të mos i atribuohet sulmuesit Randal Kolo Muani. Francezi po shijon sezonin më të mirë në karrierën e tij. Ai është përfshirë në 19 konkretizime në 17 takime në ligën gjermane (7 gola dhe 12 asistime). Së fundmi, 24-vjeçari ka folur mbi golin e fundit dhe admirimin ndaj Bayernit. "Ishte ndjesi e bukur të shënoja në një stadium fantastik si ai i Bayernit. Ata e kthyen takimin në arenë spektakli. Do të ishte ëndërr të luaja një ditë me ngjyrat e tyre. Megjithatë dua ta gëzoj formën e mirë që po përjetoj me Frankfurtin. Këtu kam mësuar shumë gjëra dhe jam i bindur se ende cikli im me ta nuk ka përfunduar. Mbyllja e sezonit mes më të mirëve të Bundesligës mbetet objektivi madhor", ka thënë Kolo Muani.

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Pasqyra e të ardhurave për tremujorin që përfundon me: 31.12.2022 Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	3,819	5,505
Shpenzimet e interesit	- 1,130	- 1,760
Neto të hyrat nga interesi	2,689	3,745
Të hyrat nga tarifave dhe komisionet	405	463
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	- 136	- 190
Neto të hyrat nga tarifave dhe komisionet	269	273
Neto të hyrat nga tregtimi	16	20
Neto të hyrat nga instrumentet tjera financiare	-	0
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	- 1,271	- 2,125
Gjithsej të hyrat	1,702	1,912
Provizionet për humbjet nga kreditë	- 1,254	- 1,091
Provizionet tjera	- 4	- 65
Fitimi/(humbja) para tatimit	445	887
Shpenzimet e tatimit në fitim	- 56	- 152
Shpenzimet e tatimit të shtyr	-	-
Fitimi/(humbja) neto	389	734
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	389	734



Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A. Mitrovicë

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURISIT

Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A -Mitrovicë zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

1(Një) Arkëtar/Inkasant - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Mitrovicë - i Konkursit të rishpallur me datë 11.01.2023

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej datës **01.02.2023**. deri me datë **07.02.2023** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë

Ziraat Bank TC.ZIRAAT BANKASI A.S - DEGA NE KOSOVE

Bilanci i gjendjes me : 31.12.2022 Euro'000

	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	10,521	11,661
Kërkesat ndaj bankave	1,299	10,690
Bonot e thesarit	-	-
Investimet në letra me vlerë	6,121	6,811
Kreditë dhe paradhënitë ndaj klientëve	91,457	95,909
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,418	1,415
Pasuritë e paprekshme	155	139
Pasuritë tatimore të shtyra	-	-
Pasuritë tjera	137	128
Gjithsej pasuritë	111,108	126,752
Detyrimet		
Depozitat e klientëve	76,103	83,566
Detyrimet ndaj bankave	24,248	22,258
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	872	699
Gjithsej detyrimet	101,224	106,522
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	10,000	20,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur/(humbja) nga vitet paraprake	504	504
Fitimi/(humbja) e vitit aktual	389	734
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	9,885	20,230
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti i aksionarëve	111,108	126,752

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gëzim Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Bregor Doda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari".

- Anton Doda nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari"

- Irfan Kusari nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f. "Mustafa Bakija" nga kl. I deri kl. VIII.

- Burhan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.

- Dardan Pjetraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Agron Krrakaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së 10-të të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



Në bazë të dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/15 qershor 2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/30 maj 2012), nenit 15 paragrafi 15.2 pika 15.2.5 të Statuti i Ndërmarrjes Publike Komunale "Trafiku Urban" – SHA. Bordi i Drejtorëve i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A., në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur më datë: **27/01/2023** mori vendim që të shpall:

KONKURS

Kryeshef Ekzekutiv në ndërmarrjen N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A Prishtinë Të përgjithshme

Kandidati për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili i plotëson kushtet e kualifikimit, kriteret e pavarësisë, duhet të ketë përvojë të nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, dhe kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Mandati i Kryeshefit Ekzekutiv

Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Bordi i Drejtorëve për mandatin prej 3 (tre) vjetëve, me mundësi të vazhdimit edhe për një mandat.

Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshefit Ekzekutiv do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve në N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A., në përputhje me rregulloren e brendshme për paga të ndërmarrjes.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Sipas rregullores së brendshme për organizimin e vendeve të punës.

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Diplomë Universitare, së paku 240 ECTS në fushat të ndërlidhura me aktivitetet me të cilat vepron Ndërmarrja. Përbushë kushtet dhe kualifikimet sipas legjislacionit në fuqi;
- Të ketë së paku 5 vjet përvojë në menaxhim të lartë (pozita të larta drejtuese);
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme;
- Shkathtësi të mira në punën me kompjuter;
- Njohuri në gjuhën angleze e preferuar.

Informatë për procedurën e konkurrimit

- Kandidati duhet t'i dorëzojë dokumente në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban vetëm në zarfë të mbyllur;
- Aplikacionin;
- CV-në;
- Letër motivimin;
- Dëshminë mbi kualifikimin profesional;
- Dëshminë mbi përvojën e punës;
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Listën kontrolluese për aplikacionin, të plotësuar.
- Deklaratën nën betim

Aplikanti duhet ta vendosë nënshkrimin, datën si dhe deklaratën nën betim ku deklarohet që i përmbushë të gjitha kushtet e pranueshmërisë. Kjo deklaratë bashkë me listën kontrolluese për aplikacionin mund të shkarkohen nga ueb faqja e Ndërmarrjes N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. <http://www.trafikurban-pr.com>

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura të aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën.

Çdo përgjeshtrim material, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca, ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipërpërmendur, do të rezultojë me diskualifikimin menjëhershëm.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. Prishtinë, ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe inkurajon të gjitha femrat e meshkujt e të gjitha komuniteteve që i plotësojnë kriteret e konkursit që të aplikojnë.

Ky proces i rekrutimit do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit Britanik dhe Shoqëria Civile për rekrutim dhe pozita në larta, sipas vullnetit të tyre. Kandidatët njoftohen se emrat, notimi dhe emërimi i kandidatëve me notimin më të lartë në këtë konkurs mund të publikohet në faqen e këtij projekti dhe në faqen e N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A në internet dhe se me aplikimin për këtë pozitë do të konsiderohet se ata e kanë dhënë pëlqimin për publikimin në fjalë.

Vlerësimi formal i kandidatëve dhe intervista do të bëhet në një kohë optimale pas përfundimit të afatit për aplikim. Bordi i Drejtorëve i N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. e mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikantët si dhe përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm në formë fizike në zyrën nr.5 të Trafikut Urban në orarin administrativ.

Konkursi është i hapur nga data 01.02.2023 dhe përfundon më datë 02.03.2023 në ora 16:00

Për detaje të më shumta ju lutem vizitoni ueb faqen tonë zyrtare www.trafikurban-pr.com

Datum:

31.01.2023

2



Na osnovu odredaba člana 21. Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća ("Službeni list Republike Kosovo", br. 31/15 jun 2008), odnosno član 13 Zakona br. 04/L-111 za izmenu i dopunu zakona br. 03/L-087 za Javna preduzeća (Službeni list Republike Kosovo" br. 13/30. maj 2012), član 15 stav 15.2 tačka 15.2.5 Statuta Opštinskog javnog preduzeća "Trafiku Urban" SHA. Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SHA., u Prištini, na sednici održanoj: 27.01.2023.godine, odlučio je da saopšti:

KONKURS

Izvršni Direktor kompanije N.P.K. "Trafiku Urban" SHA Priština

General

Kandidat za ovo radno mesto mora biti pošteno lice, koje ispunjava uslove kvalifikacije, kriterijume nezavisnosti, mora imati potrebno stručno iskustvo i traženu stručnu spremu i druge uslove propisane odredbama Zakona o javnim preduzećima.

Mandat Glavnog Izvršnog direktora

Izvršnog Direktora imenuje Upravni Odbor na period od 3 (tri) godine, sa mogućnošću produženja za još jedan mandat.

Kompenzacija Glavnog Izvršnog direktora

Naknade i beneficije glavnog Izvršnog Direktora utvrđice Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SHA. u skladu sa internim pravilnikom o zaradama preduzeća.

Dužnosti i odgovornosti:

- Prema internom pravilniku za organizaciju radnih mesta.

Kvalifikacije i stručna obuka

- Visoka stručna sprema, najmanje 240 ESPB iz oblasti koje se odnose na delatnost kojom Društvo posluje. Ispunjava uslove i kvalifikacije u skladu sa zakonom na snazi;
- Imati najmanje 5 godina iskustva u višem rukovodstvu (više rukovodne pozicije);
- Da poseduje organizacione sposobnosti, liderstvo i odlične komunikacijske veštine;
- Dokazane veštine u radu sa grupama i organizacijom preduzeća ili slično;
- Dobro poznavanje rada na računaru;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

Informacije o konkursnoj proceduri

Kandidat mora dostaviti dokumenta u fizičkom obliku u kancelariju broj 5 Gradskog saobraćaja samo u zatvorenoj kovrti:

- Aplikacija;
- SI-VI;
- Motivaciono pismo;
- Dokaz o stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Uverenje koje nije pod istragom (ne starije od šest meseci);
- Kopija lične karte;
- Kontrolna lista za aplikaciju, popunjena.
- Izjava pod zakletvom

Podnosilac prijave mora potpisati, datirati i dati izjavu kojom izjavljuje da ispunjava sve uslove podobnosti. Ova izjava zajedno sa kontrolnom listom za prijavu može se preuzeti sa veb stranice preduzeća N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. u Prištini <http://www.trafikurban-pr.com>

Naziv radnog mesta mora biti jasno naveden u prijavi, a dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i ne vraćaju se. Prijave podnete nakon isteka roka se ne prihvataju, a nepotpune prijave se odbijaju.

Kandidati koji konkurišu moraju tačno da unesu adresu i kontakt telefon, kao i mejl adresu.

Svako materijalno falsifikovanje, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. Priština nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i podstiče sve žene i muškarce iz svih zajednica koji ispunjavaju kriterijume konkursa da se prijave.

Ovaj proces zapošljavanja će pratiti predstavnici Britanskog projekta i Civilnog društva za zapošljavanje i rukovodeće pozicije, prema njihovoj volji. Obavještavaju se kandidati da se imena, rejting i imenovanje kandidata sa najvećim rejtingom na ovom konkursu mogu objaviti na sajtu ovog projekta i na sajtu N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A online i da će se prijavom na ovu poziciju smatrati da su dali saglasnost na predmetnu publikaciju.

Formalna procena kandidata i intervjui će se obaviti u optimalno vreme nakon roka za prijavu. Upravni odbor N.P.K. "Trafiku Urban" SH.A. zadržava pravo formiranja uže liste kandidata kao i izbora glavnog izvršnog direktora.

Način primene:

Prijava se može podneti samo u fizičkom obliku u kancelariji 5 Gradskog saobraćaja u administrativno vreme.

Konkurs je otvoren od 01.02.2023 i završava se 02.03.2023 u 16:00 časova.

Za više detalja posetite našu zvaničnu veb stranicu www.trafikurban-pr.com

Data:

31.01.2023

2



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten free



cilësi e garantuar

pa konservues